



## P R O C E S V E R B A L

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më **12.11.2021**, me fillim në ora **09.00**. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

**Kryesuesi** – Fillimi shqyrtime më lejoni të përshëndes, nënkyetarin **Fatmir Iska**, te nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtoret e drejtive, përfaqësues të mediave dhe të gjithë ju të pranishëm.

Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozoj këtë :

## R E N D D I T E

- 1. Shqyrtimi dhe aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i Propozim vendimit për miratimin e Draft Planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri ne Bashkësi ( KKSB ) për vitin 2022,**
- 3. Shqyrtimi i Propozim vendimit te Draft Planit të punës se Kuvendit të Komunës për vitin 2022,**
- 4. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Draft Planit të Punës se Kryetarit të Komunës për vitin 2022,**
- 5. Të ndryshme.**

Të nderuar anëtarë te KPF-së, e qesim ne votim rendin e ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet rendit i ditës. Kalojmë ne pikën e parë te rendit te ditës:

**1. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.**

**Rasim Fazliu** – Përshëndetje për ju kryesues, nënkyetarin, anëtarët komitetit për politikë dhe financa dhe gjithë te pranishmit ne sallë. Mendoj se është bërë një lëshim këtu pasi nuk besoj që mund te kem thënë kështu ku te diskutimi im te rreshti i fundit ne faqen e parë shkruan „të hyrat nga gjobat dhe gjykata që është gabim pasi që do te duhet te jetë gjobat e gjykata që realisht është e pakuptimtë si dhe ne faqen e dytë ne rreshtin e tretë kemi „si për taksa rrugore për vitin 2021 dhe këtu duhet me qenë se planifikimi ka qenë 85,000 euro kurse realizimi është bërë 254,000 euro, kurse këtu e keni shkruar që si taksa rrugore për vitin 2021, e keni shkruar dy herë realizimi dhe sigurisht se duhet te përmirësohet kjo pasi është dokument zyrtar.

**Kryesuesi** – Faleminderit z. Fazliu, atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, e qesim ne votim pikën e parë te rendit te ditës. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e dytë **Shqyrtimi i Propozim vendimit për miratimin e draft planit të punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi ( KKSB ) për vitin 2022.**

**Fatmir Iska** – Faleminderit i nderuari kryesues, te nderuar anëtarë te Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtore të drejtive dhe gjithë ju te pranishëm. Ne e kemi edhe si obligim pasi e kërkon edhe transparencë por edhe performanca që te miratojmë këtë planë te këshillit komunal për siguri dhe bashkësi, pasi është rregull që gjashtë mbledhje te mbahen brenda vitit dhe ne këtë vit i kemi mbajtur 6 dhe kërkjmë që ne dhjetor te mbajmë edhe seancën e shtatë. Kështu që edhe këtu i kemi te përcaktuar ne këtë plan te mbajtjes se seancave apo mbledhjeve te KKSB-së dhe është planifikuar që ne Janar, Prill, Mars, Qershori, shtator dhe ne dhjetor dhe zakonisht pikat e rendit te ditës janë standarde por ka raste që kërkohet prej komuniteteve shqyrtohen edhe çështje tjera.

**Kryesuesi – Faleminderit nënkyetar, atëherë meqë nuk ka tjerë te lajmëruar sa i përket pikës se dytë te rendit te ditës, konstatojmë se kalon për kuvend edhe pika e dytë e rendit te ditës.**

**Shqyrtimi i Propozim vendimit të Draft Planit të Punës se Kuvendit për vitin 2022.**

**Kryesuesi – Të nderuar kolegë, ne për çdo vite kemi pasur dhe kemi mbajtur takime ne bashkëpunim me anëtaret e Komitetit për Politikë dhe Financa pastaj me anëtaret e Komitetit për Komunitete, te gjithë drejtoresh e drejtoreve komunale mirëpo në këtë vite për shkak se ishim ne vit zgjedhor i cili filloj para muajit tetor, kështu që kemi konsideruar që ta sjellim si draft njëherë planin e punës se kuvendit për vitin 2022. Pra nëse drejtoresh apo anëtaret e komitetit për politikë dhe financa mendojnë se duhet te bëhet ndonjë ndryshim tek plani i punës për vitin 2022 atëherë mund te i diskutojmë edhe sot dhe ta rregullojmë, por ajo që është me rendësi që kuvendi çdo here e ka rregullua planin e punës për vitin tjetër pasues, meqenëse jemi ne muajin nëntor edhe do te jetë edhe mbledhja e fundit te kësaj legislature, ne duhet ta aprovojmë një plan te punës. Kështu që nëse ka dikush diçka te shtonit sa i përket këtij drafti te planit te punës se kuvendit atëherë edhe mund ta diskutojmë.**

**Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, unë kam një vërejtje fillimisht sepse nuk janë te regjistruan me numra që me pas me lehtë edhe për neve pastaj ne faqe e katërt shkruan aty se ne këtë plan synohet arrija e objektivave për vitin 2022, ku kuvendi i komunës se Rahovecit planifikon te mbajt dhjetë seancat te rregullta. Unë e di që krejt normale është me i mbajt dhjetë seanca te rregullta dhe është mirë por ne në komunën tonë gati çdo herë i mbajmë 12 seanca te rregullta dhe këtu do te ishte mirë pasi është fjalë për planifikimin sepse planifikimi gjithmonë duhet me qenë me i madhe se sa realizimi dhe do te ishte mirë me shkrue se janë mbajt mbi dhjetë mbledhje, edhe ne faqen tjetër e thotë krejt ndryshe pasi thotë ne planin e punës janë paraparë minimum dhjetë seanca te rregullta por sipas nevojës mund te mbahen edhe seanca tjera përfshirë këtu edhe seancat e jashtëzakonshme prandaj do te ishte mirë me cekë se mbahen me shume se dhjetë mbledhje. Po ashtu edhe një fjalë që e pash ne po te njëjtën faqe pasi kam edhe gjuhëtarët këtu ku shkruan mbikëqyr dhe do te ishte mirë me ja heqë shkronjën „ë“, se nuk është ne rregull, kështu që pr gjëra tjera do te diskutojmë edhe ne mbledhje te kuvendit.**

**Kryesuesi – Është e vërtet që ne bazë te udhëzimit administrativ dhe ligjit për vetëqeverisje lokale që parashihen që kuvendet komunale te paktën ti kenë dhjetë mbledhje te rregullta gjat gjithë vitit dhe ato te janë 5 ne gjashtëmujorin e parë dhe 5 ne gjashtëmujorin e dytë. Kështu që ne për shkak te kërkeseve dhe obligimeve që i kemi prej qytetareve kemi mbajt 12 mbledhje ne vite duke përashtuar mbledhjet solemne dhe mbledhje tjera ku kemi pasur edhe raste tjera. Atëherë meqë nuk kemi tjerë te lajmëruar, konstatojmë se kalon për kuvend edhe pika e tretë e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e katërt te rendit te ditës:**

**2. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Draft Planit të punës se Kryetarit të Komunës për vitin 2022.**

**Fatmir Iska – Është plani i punës se kryetarit te Komunës për vitin 2022, ku ne këtë plan janë te pasqyruara prioritetet e programit qeverisës qëndrimet pastaj prioritetet për vitin 2022 që janë synimet sfidat kryesore që na presin për vitin 2022 dhe pastaj planet e punës për secilën drejtori pastaj planet e punës se zyrës se kryetarit, kështu që nuk dua te zgjatem me tepër pasi ju e keni materialin para vetes rrëth programit te kryetarit, kështu që nëse ka diçka ne i mirëpresim sugjerimet e juaja.**

**Kryesuesi – Faleminderit nënkyetar, a ka dikush sa i përket planit te punës se kryetarit. Atëherë meqë nuk kemi, konstatojmë se kalon për kuvend pika e katërt e rendit te ditës. Kalojmë ne pikën e pestë:**

**3. Të ndryshme.**

Atëherë meqë nuk kemi të lajmëruar, ju falënderoj te gjithëve për kontributin e dhënë dhe ju njoftoj se mbledhjen e kuvendit po planifikojmë të mbajmë me datë 22.11.2021 nëse KQZ nuk mbërrin me certifikua kryetaret e komunave dhe pjesën e asamblesë por nëse mbërrin me u certifikua atëherë ne udhëzim administrativ shkruan se ne momentin që bëhet inaugurimi i kryetareve te rindj dhe asamblistëve atëherë pushon mandati i kuvendit që kanë qenë te zgjedhur deri ne atë moment. Kështu që ne po shpresojmë që para inaugurimit të mbajmë mbledhjen e kuvendit por për çdo risi do ju mbajmë te informuar. Faleminderit shume për kontributin e dhënë dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësi,

Agim Hoti

